



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 41
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10
Prishtinë, më 17 maj 2019, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Drita Millaku, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Miljana Nikoliq, Bekim Haxhiu dhe Flora Brovina.

Pjesëmarrës tjerë: Urtinë Maloku – KDI, Mirlinda Zhushi – GPLDK, Vatra Qehaja - GPVV dhe mediat.

Stafi mbështetës: Shprese Ramosaj-Haxhijaj-Koordinatorë, Greta Avdyli, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 25.04.2019;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 25.04.2019

Procesverbali, i mbledhjes së datës 25.04.2019, u miratua pa asnjë ndryshim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social

Kryetarja në pika të shkurta njoftoi anëtarët e komisionit, të cilët nuk kanë qenë pjesë e grupit punues për KES, rreth punës që është bërë gjatë kësaj kohe. Përgjatë plotësim-ndryshimit të këtij projektligji ka pasur takime me grupe të interesit, pastaj është organizuar dëgjim publike dhe po ashtu është realizuar edhe një vizitë në Slloveni. Gjatë tërë kësaj kohe FES dhe IKS kanë qenë përkrahës dhe kanë dhënë ndihmën e tyre në punën në projektligjin për KES, andaj kryetarja i falënderoi në emër të anëtarëve të komisionit. Ajo më pas i kaloi fjalën kryesuesit të grupit punues të KES, deputetit Enver Hoti.

Enver Hoti falënderoi anëtarët e grupit punues, përfaqësuesit e MPMS, përfaqësuesit e OJQ-ve të cilët kanë ndihmuar, si dhe të gjithë aktorët të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë punë. Ai shprehi gatishtësinë e tij për procedimin e mëtejshëm të amendamenteve dhe po ashtu kërkoi edhe njëherë opinionin e anëtarëve të komisionit, nëse ka diçka për t'u shqyrtuar eventualisht.

Kryetarja informoi anëtarët e komisionit se nuk ka pas amendamente nga deputetë të tjerë apo nga anëtarë të tjerë të komisionit. Këto amendamente janë 14 në numër dhe janë bërë në emër të komisionit.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku paraqiti qëndrimin partiak të saj, duke thënë se do të abstenoj për shkak të konceptit jo të mirë të Projektligjit. Sipas saj vendimet e këtij Këshilli nuk e kanë fuqinë të cilën do të duhej ta kishin. Ajo po ashtu dha vërejtjet e saj edhe për administratën mbështetëse të KES dhe buxhetin, ku ajo mendon se buxheti i paracaktuar nuk do të mund të mbulojë të gjitha detyrat e cekura në këtë projektligj. Ajo sqaroi se vërejtja nuk ka të bëjë me punën e grupit punues dhe nenet konkrete po për mënyrën e funksionimit të KES, si dhe si është trajtuar ky projektligj.

Kryetarja tha se këto që u thanë ne do t'i diskutojmë, por tani t'i hedhim në votim amendamentet e grupit punues:

Komisioni me 6 vota për, dhe dy abstenime të deputeteve Fatmire Mulhaxha – Kollçaku dhe Drita Millaku, miratoj amendamentet e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social dhe i procedoj për shqyrtim të komisionet e përhershme.

4. Të ndryshme.

Kryetarja prezantoi para anëtarëve të komisionit shkresën e ish- policëve të viteve të 90 – ta, dhe tha se edhe në mandatin e kaluar komisioni ka marrë kërkesa nga Federata Sindikale e Administratës Publike dhe të ish -Policisë së Kosovës, ku edhe kanë qenë të pranishëm për diskutime në komision. Ata kërkojnë që neni 8 i Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti të ndryshohet sepse, sipas tyre, ky nen është diskriminues. Ajo tha se ky nen diskriminues nuk është vetëm për ish- policët, mirëpo prek të gjithë ata të cilët janë larguar me dhunë nga puna në vitet e 90-ta. Ne i kemi përkrahur këto kërkesa dhe besojmë se komisioni që është duke punuar për reformën pensionale do t’ i ketë parasysh edhe këto kërkesa.

Enver Hoti falënderoi Sindikatën e ish- Policisë dhe po ashtu shtoi se Kuvendi i Kosovës ka formuar një grup punues për Reformën Pensionale, ku do të trajtohen të gjitha mundësitë për këtë skemë dhe për plotësimin e këtyre kërkesave. Ai më pas u ndërlidh me temën e mëparshme për diskutimin e Projektligjit për KES-it, duke thënë se secili deputet dhe parti politike ka qëndrimin e vet, mirëpo ai theksoi se mos-pjesëmarrja në hartimin e Reformës Pensionale nuk është e qëndrueshme, dhe arsyetimet si të tilla janë jo të qëndrueshme. Sipas tij arsye e vetme është se ligjet dhe dokumentet ekzistojnë, ndërsa zbatimi i tyre varet nga ata të cilët janë të obliguar për t’i zbatuar. Ai tha se të gjithë ata të cilët kanë mundësi të japin kontributin e tyre përmes vizioneve të tyre është mirë t’i sjellin alternativat dhe idetë dhe t’i bëjnë pjesë të këtyre dokumenteve si në fazën e hershme të hartimit, po ashtu edhe në fazën përfundimtare. Ai konsideron se shmangia tregon një jo përgjegjësi totale.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku iu kundërpërgjigj deputetit Enver Hoti duke thënë se nuk i është shmangur asnjë përgjegjësie dhe nuk e kundërshtoi Projektligjin në mënyrë të plotfuqishme, mirëpo zgjodhi abstenimin si mundësi duke parë se nuk mund të ndryshohet koncepti i ligjit në tërësi. Sipas saj jo përgjegjësi është mos-zbatimi i ligjeve në fuqi. Ajo shtoi se ky ligj duhet të përkrahët dhe t’i jepet kompetenca e cila sipas saj nuk i është dhënë deri më tani.

Enver Hoti tha se çështja e moszbatimit të ligjeve duhet ndarë nga faza ku ndodhemi ne pra, faza e amendamentimit të një ligji. Ne duhet ta bëjmë një ligj sa më të mirë dhe duhet të japim kontribut e mos t’i ikim përgjegjësisë. Sa i përket zbatimit janë institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal që kanë përgjegjësi ta zbatojnë. Ju tani po thonë se koncepti është i gabuar, na propozoni cili është koncepti i drejt sipas jush. Ndërsa sa i përket buxhetit, ne e kemi parapa buxhetin e mjaftueshëm për zbatim të ligjit.

Drita Millaku tha se nuk është qëllimi kryesor për të kundërshtuar Projektligjin, mirëpo sipas saj ky ligj nuk ka funksionuar në realitet, apo mënyra e funksionimit të Këshillit ka qenë si një rezultat i mungesës së punës ku edhe është dashur që të bëhet një ndryshim. Ajo shtoi se grupi parlamentar i saj e konsideron se ky ligj me këto ndryshime nuk do të mund të funksionoj edhe në të ardhmen. Ajo theksoi se këto bindje janë partiake dhe do të mbrohen me çdo kusht. Sipas saj forma se si është proceduar dhe është amendamentuar, ky ligj do të jetë jo-funksional dhe që mos të jetë i implementueshëm në të ardhmen.

Haxhi Avdyli konsideroi se deputetët hynë në një debat ta panevojshëm. Sipas tij është e rëndësishme që Ligji kaloj dhe se nuk ka të drejtë askush që të reagojë ashpër ndaj qëndrimeve politike të dikujt tjetër.

Kryetarja tha se e vetmja vërejtje është se këto ide dhe alternative do të duhej të paraqiteshin gjatë grupit punues dhe të inkorporoheshin gjatë punës. Ajo shtoi se gjatë punës së grupit punues nuk ka pasur vërejtje nga përfaqësuesja e grupit të LVV, deputetja Drita Millaku. Ajo më pas tha se në mandatin e kaluar ajo ka qenë pjesë e grupit punues si përfaqësuese e LVV dhe të gjitha rekomandimet gjatë fazave të amendamentimit i kanë parashtruar në grup punues, andaj si vërejtje të vetme kishte mos-paraqitjen e rekomandimeve dhe propozimeve në fazat e punës në grup punues.

Enver Hoti tha se nuk është synim i tij të ndikojë në asnjë grup politik, mirëpo vetëm të pranohet qëndrimi i secilit sepse është demokratike, mirëpo nuk mund të heshtim për shkak se secili grup politik merr pjesë në komisione dhe në Kuvend dhe më pas ngritin çështje apo tema të cilat më pas nuk duan t'i votojnë. Sipas tij e drejtë e secilit është që të mos marrin pjesë as në komisione, as në seanca plenare, mirëpo atakimi i dokumentit me arsyen se nuk ka buxhet apo nuk është koncepti funksional është i pa tolerueshëm. Sipas tij dokumenti është profesionalisht, në rregull, dhe do t'i shërbej qëllimit për të cilin është hartuar.

Kryetarja informoi anëtarët se Ambasada Suedeze do që të ketë një takim me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për të biseduar rreth pushimit të lehonisë dhe pushimit prindëror, në mënyrë që të japin rekomandimet dhe propozimet e tyre, edhe pse ky projektligj ende nuk ka arritur në Kuvend.

Enver Hoti tha se refuzon të marrë pjesë në takimin me Ambasadën Suedeze për arsye se konsideron që së pari duhet të takohen me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe pastaj me institucione të tjera. Ai tha se është e paarsyeshme që të kërkohen dokumente të reja, e të mos trajtohen dokumentet të cilat janë aktuale.

Kryetarja tha se pas pajtimit të shumicës takim me Ambasadorin e Suedisë mbahet javën tjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU